



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 456/4 Prot.

Tiranë, më 02.10. 2015

V E N D I M
Nr. 107, datë 02.10. 2015

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 456/1, datë 09.07.2015**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për rastin e nëpunësit ***** ,

VËREJ SE,

Në zbatim të Urdhrit nr. 456/1 prot., datë 09.07.2015, është nisur verifikimi i ligjshmërisë së procedurës së lirimimit nga detyra e Specialistit të Shpërndarjes, në Sektorin e Shpërndarjes, Mbikëqyrjes e Realizimit të Kontratave dhe Donacioneve, në Qendrën e Furnizimit Matërialo-Teknik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të punonjësit ***** .

Nga shqyrtimi i akteve të sjella më shkresën nr. 456 prot., datë 25.06.2015 prej kërkuesit ***** , me shkresën nr. 456/3 prot, datë 21.07.2015, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe me autorizimin nr. 542 prot., datë 27.07.2015, rezulton se ***** është emëruar Shef Seksioni, në Seksionin e Shpërndarjes, Mbikëqyrjes e Realizimit të Kontratave dhe Donacioneve, në Qendrën e Furnizimit Materialo-Teknik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me Urdhrin nr. 1795/1, datë 31.12.2013 "Për emërimin në detyrë të një punonjësi të shërbimeve mbështetëse".

Me Urdhrin nr. 944/1, datë 08.03.2014 "Për emërimin në detyrë të një punonjësi të forcave mbështetëse", ***** është emëruar Specialist Shpërndarje, në Seksionin e Shpërndarjes, Mbikëqyrjes e Realizimit të Kontratave dhe Donacioneve, në Qendrën e Furnizimit Materialo-

Teknik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me kategori page IV-b. Pas emërimit në këtë detyrë, ***** është liruar nga detyra me Urdhrin nr. 944/3, datë 26.07.2014 “Për lirim nga detyra të një punonjësi të shërbimeve mbështetëse”, me motivacionin për tu emëruar në një detyrë tjetër në strukturat e Policisë së Shtetit. Rezulton se pas këtij akti, punonjësi *** **** jo vetëm që nuk është emëruar në një detyrë tjetër, por me Urdhrin nr. 944/4, datë 06.11.2014 “Për lirim nga strukturat e Policisë të një punonjësi të shërbimeve mbështetëse”, është vendosur zgjidhja e kontratës së punës për ***** dhe lrimi i tij nga strukturat e shërbimeve mbështetëse të Policisë së Shtetit, me arsyetimin e pamundësisë së emërimit të tij në një detyrë tjetër.

Nga dokumentacioni i administruar, vërehet se data e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, konkretisht data 26.02.2014, e ka gjetur punonjësin ***** në pozicionin Shef Seksioni, në Seksionin e Shpërndarjes, Mbikëqyrjes e Realizimit të Kontratave e Donacioneve, në Qendrën e Furnizimit Materialo-Teknik. Për këtë arsye, bazuar në nenin 67, pika 3 e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, Departamenti i Administratës Publike me shkresën nr. 1491/2, datë 30.10.2014, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësin ***** , si nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin Shef Seksioni.

Por, veç sa sipër, rezulton gjithashtu se, kërkuesi ***** ndaj veprimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ka paraqitur kërkesë padë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nëpërmjet të cilës ka kërkuar:

“Shfuqizimin tërësisht të urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 944/1, datë 08.03.2014 “Për lirim nga detyra të një punonjësi të shërbimeve mbështetëse”;
*Detyrimin e palës së paditur DPPSH të dëmshpërblejë paditësin ***** me pagën e 12 muajve për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustifikuar të marrëdhënies së punës;*
*Detyrimin e palës së paditur DPPSH të dëmshpërblejë paditësin ***** me pagën e 2 muajve për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës;*
*Detyrimin e palës së paditur DPPSH të dëmshpërblejë paditësin ***** me pagën e 3 muajve për mosrespektim të afatit të njoftimi për zgjidhjen e kontratës së punës.*
Detyrimin e palës së paditur DPPSH të paguajë të drejtat financiare sipas vendimit me nr. 183, datë 03.02.2011 në shumën 33000 lekë në muaj”.

Në përfundim të hetimit gjyqësor, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 7002, datë 01.12.2014 ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë;
*Detyrimin e palës së paditur DPPSH të dëmshpërblejë paditësin ***** me 2 paga mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës së punës;*
Detyrimin e palës së paditur DPPSH të dëmshpërblejë paditësin me 1 pagë mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit.
*Detyrimin e palës së paditur DPPSH të dëmshpërblejë paditësin ***** me 2 paga mujore për mosrespektimin e procedurës në zgjidhjen e kontratës së punës.*
Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër”.

Aktualisht, rezulton se kjo çështje, mbi bazën e ankimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ndodhet për gjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, kjo sipas kopjes se faqes online të kësaj gjykate (www.gjykataadministrativeapelit.al).

Bazuar sa më sipër, jemi përpara rastit ku organi gjyqësor është shprehur me vendim në lidhje me këtë çështje dhe pritet që të gjykohet në shkallë të dytë, prej gjykatës Administrative të Apelit, për të marrë formë të prerë.

Në kushtet kur neni 36 i Kodit të Procedurës Civile, sanksionon parimin themelor të mos shqyrtimit nga institucionet e tjera të çështjeve që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojë se në këtë rast, nuk është e nevojshme për t'u investuar apo për të ndërhyrë nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe nenin 16 dhe 34 të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me Urdhrin e verifikimit nr. 456/1 prot., datë 09.07.2015, *“Për verifikimin e procedurës së lirit për punonjësin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ***** ”*
2. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe kërkuesi, ***** .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëher.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA